



Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë (FSDK) shpallë:

Rishpallje: Konkurs për vend pune

Titulli: Zyrtar/e i/e Lartë Ligjor

Njësia: Për Çështje Ligjore dhe Pajtueshmëri

Raporton: Drejtorit Menaxhues të FSDK-së apo Udhëheqësit të Njesisë kur aplikohet

Niveli: Niveli – I, Zyrtar i Lartë

1. Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësi:

Zyrtari(ja) i/e Lartë Ligjor/e do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e çështjeve ligjore në lidhje me funksionimin e Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë (FSDK); të ofrojë këshilla ligjore për menaxhmentin dhe Bordin Menaxhues dhe të përfaqësojë FSDK-në në procese të ndryshme ligjore dhe administrative:

- Dhënia e këshillave ligjore për Drejtorin dhe Bordin Menaxhues të FSDK-së për çështje që lidhen me sigurimin e depozitave dhe ligjet e aplikueshme.
- Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore të FSDK-së, vendimeve, kontratave dhe marrëveshjeve kontraktuale që lidhen me FSDK-në.
- Monitorimi i ndryshimeve në legjislacionin e aplikueshëm dhe dhënia e rekomandimeve për amandamentimin e akteve nënligjore të FSDK-së në lidhje me fushat relevante të veprimtarisë së FSDK-së (si p.sh. prokurim, burime njerëzore, mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit, konfliktin e interesit, etj).
- Zbatimi i detyrave të fushës ligjore në rast të ngjarjes së siguruar.
- Monitorimi i pajtueshmërisë së veprimeve të FSDK-së me kornizën ligjore të aplikueshme, përfshirë ligjet, aktet nënligjore dhe marrëveshjet ndërkombëtare.
- Mbikëqyrja e procedurave ligjore që përfshijnë FSDK-në dhe përfaqësimi i interesave të FSDK-së në gjykata dhe organe të tjera administrative.
- Zbaton detyra të tjera të cilat mund të caktohen nga Drejtori Menaxhues i FSDK-së.

3. Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë apo juridike - Fakulteti Juridik ose ekuivalent.
- Kualifikimi Master në drejtësi apo barasvlershëm ose/dhe provimi i jurisprudencës do të konsiderohen si përparësi.

4. Përvoja e kërkuar:

- Të paktën pesë (5) vjet përvojë pune profesionale në fushën ligjore pas përfundimit të studimeve universitare, si p.sh. në pozita si jurist, zyrtar ligjor, ose role ekuivalente.

- Përvoja ligjore në sektorin publik apo në sektorin financiar do të konsiderohet si përparësi.

5. Aftësitë e Kërkuara

- Njohuri në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar që lidhet me sektorin financiar.
- Njohuri mbi legjislacionin e BE-së dhe procedurave legjislativë do të paraqet përparësi.
- Përgjegjshmëri dhe integritet të lartë profesional.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, dhe shkrim ligjor (formulim të vendimeve, akteve nënligjore, rekomandimeve dhe opinioneve ligjore).
- Aftësi në hulumtimin ligjor dhe në interpretimin e ligjeve dhe akteve nënligjore.
- Aftësi të mira komunikuese dhe ndërpersonale me aftësinë për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në ekip.
- Njohja e gjuhës angleze.
- Njohje e aplikacioneve të MS-Office.

6. Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet në vijim:

- CV të detajuar.
- Letrën motivuese ku theksohet interesimi për pozitën.
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it.
- Dëshmitë e përvojës punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës).
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse.
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Republikës së Kosovës.

7. Afatet Kohore dhe Procedura e Aplikimit

- Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **17 Dhjetor 2024 në ora 16:00**.
- Mund të aplikoni përmes postës elektronike në adresën: komisioni@fsdk.org ose të dorëzoni fizikisht dosjen tuaj në adresën e FSDK-së: Rr. Bekim Fehmiu, nr.31, kati i I-rë, Lakërishtë, 10 000 Prishtinë.
- Kandidatët e përzgjedhur për testim do të njoftohen brenda 15 ditëve kalendarike nga data e mbylljes së konkursit për ditën e testimit.
- Kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të informohen brenda 10 ditëve kalendarike pas datës së testimit.

Aplikacionet e pa kompletuara me 6 dokumentacionet e lartpërmendura nuk do të merren parasysh nga komisioni.